



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 32 Prot.,

Tiranë, 08 . 02 2024

VENDIM

Nr. 26, datë 08.02.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.02.2024:

VENDOSI:

1. Mosmiratimin e “Raportit Përfundimtar sipas Marrëveshjes tre-palëshe, TAP-ABKONS-MK, me objekt Vlerësimi dhe Analiza e Trashëgimisë Kulturore për gjetjet pas gërmimit, në kuadër të projektit TAP, i hartuar nga **ABKONS sh.p.k. me argumentin:**
 - Për mospërbushje të standartit dhe formatit të Raportit përfundimtar sipas Marrëveshjes tre-palëshe, TAP-ABKONS-MK, me objekt ‘Vlerësimi dhe Analiza e Trashëgimisë Kulturore për gjetjet pas gërmimit, në kuadër të projektit TAP’, si dhe kushteve të kontratës.
2. Subjekti kontraktor ABKONS sh.p.k. duhet të përfundojë paketimin dhe përgatitjen për dorëzim e të gjithë materialit arkeologjik dhe dokumentacionit teknik sipas kushteve të kontratës, nën supervizionin e grupit i ekspertëve të ngritur nga MEKI;
3. Gjetjet arkeologjike të merren në dorëzim nga ekipi i ngritur nga MEKI dhe të transferohen në Universitetin e Tiranës, Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore sipas afateve që do të përcaktohen nga MEKI;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

